3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

**D. DHËNIA E KONTRATËS**

**23. Njoftimi i Fituesit**

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

**24. Nënshkrimi i Marrëveshjes**

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen



**Kuadër/  
Kontratës**

kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) garanci bankare
- b) garanci nga shoqëri sigurimi.

**DH. ANKESAT**

**25. Procedura e  
ankesës**

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore.
2. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

**E. ANULIMI I PROCEDURËS**

**26. Anulimi i  
procedurës**

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.
2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:
  - a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë përkatëse në procedurat me faza;
  - b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;
  - c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;
  - d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;
  - e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021.
3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

## SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1. Formulari i Ofertës

Shtojca 2. Listat e Çmimeve të Shërbimeve

Shtojca 3. Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4. Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5. Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 6. Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 7. Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 8. Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 9. Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 10: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

Formulari 12- Formulari i Njoftimit të Fituesit (Në përfundim të afateve të ankimit)

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Paraparak)

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër (Në përfundim të afateve të ankimit)

## Shtojca 1

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

### FORMULARI I OFERTËS

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi në të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve të Artikujve dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
  - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme::
    1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
    2. Njoftimin e Kontratës;
    3. Kriteret e Përzgjedhjes;
    4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
    5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
    6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;
    8. Listat e Çmimeve të Shërbimeve.
- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>	
<b>Nënshkrimi</b>	
<b>Vula</b>	
<b>Datë</b> _____	

**Shtojca 2**

*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)*

**LISTA E ÇMIMEVE TË SHËRBIMEVE**

**Data:** \_\_\_\_\_

**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:** \_\_\_\_\_

**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** \_\_\_\_\_

**Monedha:** \_\_\_\_\_

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, këto do të rregullohen në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë artikujt në Formularin e Shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit duhet të hidhen dhe tu vendoset çmimi i ofruar në Listën përkatëse të Çmimeve për shërbimet. Shërbimetpa çmim do të konsiderohen si shërbime të paofruar dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

**Lista e Çmimeve \*Referohuni Aneksit 3 të publikuar në SPE si pjesë e këtyre DT**

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Njësia	Çmimi për njësi	Çmimi total
<b>1. Nderhyrje ne ACS02</b>					
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionin e Matjes Bilisht (ACS 02)</b>					
1.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/ KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune		
<b>2. Nderhyrje ne ACS03</b>					
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionin e Kompresoreve Seman (ACS 03)</b>					
2.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/ KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune		
<b>3. Nderhyrje ne ABVs</b>					
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionet e Valvulave Bllokuese</b>					
3.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/ KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune		
<b>4. Aktivitete te pergjithshme</b>					

*Albanian Gas Service Company Sh.A.*

*Rruga "Kosovareve", pallati NdërPro Sh.P.K., Tirana, Albania*

*NUIS: L82407006D*

<b>A. Aktivitetet e Mirëmbajtjes së Përgjithshme Mirëmbajtja</b>					
4.1	Rimbushja e gazit ftohës	200	Kg		
4.2	Marrja e mostrave (legionella)	40	Analize		
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>					
<b>TVSH (%)</b>					
<b>Çmimi total me TVSH:</b>					
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>					
<b>Nënshkrimi</b>					
<b>Vula</b>					
<b>Datë _____</b>					

### Shtojca 3

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

#### FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

**Shtojca 4.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)*

**Lista e Informacionit Konfidencial**

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

**VËMENDJE**

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

**Përfaqësuesi i Ofertuesit**

**Nënshkrimi**

**Vula**

## Shtojca 5

[ Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:



**Shtojca 6**

**FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:**

Nr.	Përshkrimi i shërbimit	Sasia	Njësia
<b>1. Nderhyrje ne ACS02</b>			
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionin e Matjes Bilisht (ACS 02)</b>			
1.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune
<b>2. Nderhyrje ne ACS03</b>			
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionin e Kompresoreve Seman (ACS 03)</b>			
2.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune
<b>3. Nderhyrje ne ABVs</b>			
<b>A. Aktivitetet e mirëmbajtjes në Stacionet e Valvulave Bllokuese</b>			
3.1	Nderhyrje E PAPLANIFIKUAR/KORREKTIVE - Sigurimi i personelit të specializuar, duke përfshirë shpenzimet e akomodimit dhe udhëtimit, orët shtesë, materialet e vogla te konsumueshme, veglat e dorës, shkallet/platformat për punë në lartësi, etj.	100	Dite Pune
<b>4. Aktivitete te pergjithshme</b>			
<b>A. Aktivitetet e Mirëmbajtjes së Përgjithshme Mirëmbajtja</b>			
4.1	Rimbushja e gazit ftohës	200	Kg
4.2	Marrja e mostrave (legionella)	40	Analize

Afati i realizimit do të jetë sipas **nga data e nënshkrimit të marreveshjes kuader deri me 30.09.2025.**

**Shtojca 7**

**TERMAT E REFERENCES / SPECIFIKIME TEKNIKE**

**INDEKSI**

1. QËLLIMI I SPECIFIKIMIT TEKNIK .....
2. KONTEKSTI .....
3. PËRSHKRIMI I OBJEKTEVE TË MBULUARA NGA KONTRATA .....
4. PËRSHKRIMI I NDËRHYRJEVE TË EQUIPEMENT TË KËRKUARA .....
5. RAPORTET E MIRËMBAJTJES .....
6. MJETET MINIMALE DHE TE KONSUMUESHMET E NEVOJSHME.....
7. EKZEKUTIMI I MIRËMBAJTJES NË MJEDISET E TAP-IT .....
8. GARANCITË DHE DETYRIMET E FURNIZUESIT .....
9. HSE .....
10. Anekset.....

## 1. QËLLIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Ky dokument përcakton qëllimin e punës dhe veprimtaritë teknike të mirmbajtjes që do t'i kërkojnë Operatorit Ekonomik në këte kontrate. I njëjti dokument rregullon gjithashtu edhe marrëdhëniet e punës midis shoqërisë AGSCo e dhe Operatori Ekonomik që do t'i caktohet kontrata.

Operatori Ekonomik që do të marrë përsipër kontratën do të jetë përgjegjës për të garantuar që dokumenti në fjalë i Specifikimeve Teknike të aplikohet tërësisht jo vetëm nga punonjësit e tij, por edhe nga nënkontraktorë të mundshëm të cilëve mund t'u caktojë zbatimin e disa fazave të shërbimit.

Kohëzgjatja e kontratës është e barabartë me 2 vite nga data e caktimit të saj.

## 2. KONTEKSTI I REFERIMIT

Në vazhden e marrëveshjeve të firmosura midis TAP dhe autoriteteve shqiptare, Snam Spa (Italian Transmission System Operator) e Albgaz (Albanian Transmission System Operator), kanë krijuar një joint venture të quajtur AGSCo (Albanian Gas Service Company Sh.A.), për zbatimin e veprimtarive të Kontrollit së gazsjellësit TAP (Trans Adriatic Pipeline) prezent në territorin e Shqipërisë. Pjesa shqiptare e gazsjellësit TAP është rreth 215 km dhe shtrihet nga kufiri greko-shqiptar në afërsi të Bilishtit dhe deri në kufirin me detin Adriatik në qarkun e Fierit. Gazsjellësi përshkon qarqet Korçë, Berat dhe Fier. Sistemi i transportit të gazit është i përbërë nga një tubacion i nëndheshëm që ka një diametër kryesor prej 48" (1.200 mm), 9 valvola sigurie të linjës (ABVs), një stacion matje fiskale të vendosur në Bilisht (ACS02) në kufirin shqiptaro grek dhe një stacion të kompresimit të gazit (ACS03) në rrethinat e Fierit i pajisur me tre turbokompresorë të fuqisë së instaluar prej 45 MW. Presioni maksimal i funksionimit të gazsjellësit është 90 bar ndërsa stacioni i kompresorit është funksional deri në presionin maksimal prej 145 bar. Prezenca e ambjenteve TAP në territorin e shqipërisë është e treguar në hartën e më poshtme:



Fig. 1 – Vendodhja e ambjenteve TAP përmes shtetit shqiptar.

### 2.1 SHKURTIME DHE PËRCAKTIME

ACS02	Stacioni Shqiptar i Matjes 02. Vendndodhja në Bilisht.
ACS03	Stacioni Shqiptar I Kompresorit 03. Vendndodhja në Fier.
ABV	Stacioni Shqiptar i Valvulave të Bllokimit (ABV24, 25, 26, 27, 28, 29,
ALV	Stacioni Shqiptar I Bashkimit të Valvulave (ALV32).
HSE	Health, Safety and Environment. Shëndeti, Siguria dhe Ambjenti.
AGI	Above Ground Installation. Instalime mbi Tokë
TAP	Trans Adriatic Pipeline.
AGSCo	Albania Gas Service Company.
TAP Facilities	ACS02, ACS03, ABV.
MC	Maintenance Centre. Qendra e Kontrollit
AGSCo	Korce MC, Fier Detachment, Corovodë Detachment, Tirana HQ
PPE	Personal Protection Equipment. Pajisje Mbrojtëse Personale
PTW	Permit To Work. Leje për Punë
WI	Work instructions TAP. Instruksionet e Punës së TAP
AGS-TSP-001	Maintenance of Fire and Gas Systems: Technical Specification Kontrolli i Sistemeve të Gazit dhe Zjarrit: Specifikimet Teknike
Kontrata	Kontratë mirëmbajtje kundërzjarrit shërbimet e të cilës janë përcaktuar në Specifikimet Teknike të AGS-TSP-001.
Operatori	Kontraktor të cilit do t'i besohet zbatimi i kontratës.
ATEX	ATmosphères Explosives; Ambjent eksploziv

### 3. PËRSHKRIMI I OBJEKTEVE TË MBULUARA NGA KONTRATA

Objektet e TAP	Pozicioni GPS	
<b>ACS02 – Stacioni i Matësit Bilisht</b> Bilisht - Korçe	Gjerësia:	40.582582°
	Gjatësia:	21.000683°
<b>ABV 24</b> Proger	Gjerësia:	40.690506°
	Gjatësia:	20.924912°
<b>ABV 25</b> Drenove	Gjerësia:	40.589963°
	Gjatësia:	20.720251°
<b>ABV 26</b> Vithkuq	Gjerësia:	40.517906°
	Gjatësia:	20.531710°
<b>ABV 27</b> Potom	Gjerësia:	40.491486°
	Gjatësia:	20.204008°
<b>ABV 28</b> Vendreshe	Gjerësia:	40.540174°
	Gjatësia:	20.108425°
<b>ABV 29</b> Vertop	Gjerësia:	40.675747°
	Gjatësia:	20.022549°
<b>ABV 30</b> Ura Vajgurore	Gjerësia:	40.770815°
	Gjatësia:	19.855615°
<b>ABV 31</b>	Gjerësia:	40.768788°

Albanian Gas Service Company Sh.A.

Rruga "Kosovareve", pallati NdërPro Sh.P.K., Tirana, Albania

NUIS: L82407006D

Roskovec	Gjatësia:	19.694532°
<b>ALV 32</b> Topoje	Gjerësia:	40.793353°
	Gjatësia:	19.385136°
<b>ACS03 – Stacioni i Kompresorit Fier</b> Seman - Fier	Gjerësia:	40.791871°
	Gjatësia:	19.453191°

## 4. PËRSHKRIMI I NDERHYRJEVE TË EQUIPEMENT TË KËRKUARA

### 4.1 PAJISJET E HVAC

Të gjitha pajisjet pjesë e ketyre specifikimeve teknike janë përfshirë në ANEKSI 1 - Paisjet HVAC dhe Operimi bashkangjitur me këtë specifikim teknik. Pajisjet janë të listuara sipas vendndodhjes së tyre nperkatesisht ne ACS03 Seman, ACS02 Bilisht dhe BVS të shpërndara përgjatë rrugës së tubacionit në Shqipëri.

Gjithashtu, në Aneksin 1 jepen detaje teknike të çdo pajisjeje, vendndodhje/ ndërtesat dhe karakteristika kryesore në mënyrë që Operatori Ekonomik të vlerësojë funksionalitetin dhe paisjet e instaluar. Nëse nga ana e Operatoreve Ekonomik ofertues, kërkohe ndonje detaj shtese apo informacion teknik per ndonje paisje apo sistem, mund te kontaktoje nepermjet emailit AGSco.

### 4.2 MIRËMBAJTJE/NDERHYRJE E JASHTËZAKONSHME

Nga Operatori ekonomik do të kërkohe vetem nderhyrje riparimi ne rast avarie, mosfunksionaliteti normal apo alarmi te paisjes. AGSCo do te bej kerkese prane operatorit ekonomik nepermjet emailit ose telefonit duke specifikuar:

- Vendndodhja e objektit
- Detajet e pajisjeves ku eshte e nevojshme nderhyrja
- Problemi i mundshem me paisjen
- Çdo kontroll dhe / ose riparim i sistemit të kërkuar.

Operatori Ekonomik duhet të zotërojë personel profesional dhe me kompetence teknike te afte per te nderhyre ne sistemet apo paisjet e listuara ne *ANKESIN ANEKSI 1 - Paisjet HVAC dhe Operimi*. Është përgjegjësi e Operatorit Ekonomik të zhvillojë dhe zbatojë një riparim për të mirëmbajtur në mënyrë efektive, dhe ne perputhje me rekomandimet e prodhuesit per të gjitha aspektet e pajisjeve dhe sistemet HVAC në shtojcën 1. Operatori ekonomik duhet të kryejë ndërhyrjen brenda një kohe maksimale prej 2 ditësh duke filluar nga data e kërkesës dhe në çdo kohë të vitit. Punonjesit e operatorit ekonomik do te shoqerohen nga inxhinieret e Autoritetit kontraktor te cilet do te krijojne akses ne ambientet e TAP dhe do te ndihmjne stafin e ooperatorit ekonomik me :

- Perpilimin e lejes se punes
- Shoqerimin ne impiant
- Izolimet elektrike dhe mekanike te energjise
- Sigurimin e Projekteve, detajeve teknike (nese eshte e nevojshme)
- Supervizimin e te gjithe aktivitetit.

Sic u tha mesiper Operatori Ekonomik do te nderhyje per te kryer riparime te mundshme me kerkese te Autoritetit Kontraktor. Pas nderhyrjes, Operatori Ekonomik duhet te perpiloje nje raport ku spjegohet aktiviteti ditor I realizuar dhe gjetjet e mundshme. Gjithastu mund te pershkruhen edhe rekomandime apo kerkesa te pajisjeve.

Të konsumueshmet për ekzekutimin e mirëmbajtjes së jashtëzakonshme do të garantohen nga furnizuesi dhe kostot e lidhura duhet të përfshihen në normat e njësisë të raportuara në kontratë.

Për të kryer shërbimin, kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë e pajisjeve të nevojshme. Të gjitha pajisjet duhet të përputhen me standardet ndërkombëtare, të certifikohen dhe të kenë një certifikatë të vlefshme kalibrimi.

Në ANEKSI 3 - *SQARIME MBI OFERTEN EKONOMIKE* raportohet struktura e listës së çmimeve të përfshira në kontratë, me sqarim të zërave.

## **5. RAPORTET E MIRËMBAJTJES**

Në përfundim të nderhyrjes kontraktori do të sigurojë në maksimum 3 ditë pune një raport ku përshkruhet nderhyrja e kryer. Raporti duhet të përmbajë dëshmi fotografike, dhe detaje të tjera të nderhyrjes si:

- Data dhe ora e fillimit dhe përfundimit të nderhyrjes
- Përshkrimi i problemeve të hasura dhe shkaku rrënjësor.
- Përshkrimi i aktiviteteve të kryera në përgjigje të nderhyrjes së jashtëzakonshme
- Emrat e personelit të përfshirë
- Lista e pajisjeve të përdorura
- Lista e të konsumueshmeve të përdorura për nderhyrjen
- Lista e pjesëve të këmbimit jo në kontratë por të nevojshme për të rivendosur funksionimin e duhur të fabrikës
- Parametrat dhe gjetjet e punës
- Sistemet e mirëmbajtura dhe operacionet e kryera;
- Pjesët e zëvendësuara, të riparuar ose të riparuar;
- Cilindrat e rimbushur, zëvendësuar ose lëvizur për ri-testim;

"Raporti i mirëmbajtjes" do të hartohet në fund të çdo nderhyrjeje, në kundërshtim me Përfaqësuesin e AGSCo-së, duhet të nënshkruhet si nga operatori ekonomik ashtu edhe nga Përfaqësuesi i AGSCo-së dhe duhet të dërgohet me postë në AGSCo, e plotësuar me sa më sipër, brenda 5 ditëve pune nga përfundimi i nderhyrjes.

Përpara kryerjes së ndonjë riparimi dhe/ose zëvendësimi të pajisjeve, kontraktori duhet të marrë autorizimin nga Përfaqësuesi i AGSCo.

## **6. MJETET MINIMALE DHE TE KONSUMUESHMET E NEVOJSHME**

Operatori Ekonomik duhet të sigurojë mjetet e punes dhe te konsumueshmet e nevojshme për të kryer Shërbimet. Të gjitha mjetet dhe pajisjet duhet të jenë të përshtatshme për qëllim, në kushtet e duhura të punës. Pajisjet matëse dhe testuese duhet të kenë një kalibrim të vlefshëm dhe certifikata e kalibrimit duhet të jetë e pranishme.

Për të marrë pjesë në tender, operatori ekonomik duhet të demonstrojë se zotëron të paktën pajisjet dhe konsumuesit e mëposhtëm për të kryer pjesën e shërbimit të këtij specifikimi.

### **Të konsumueshmet:**

Më poshtë është raportuar lista e minimumit të konsumueshmeve për të cilin kontraktori duhet të garantojë disponueshmërinë.

## **7. EKZEKUTIMI I MIRËMBAJTJES NË MJEDISËT E TAP-IT**

### **7.1 AKTIVIZIMI I SHËRBIMIT, HYRJA NË AMBIENTET E TAP-IT**

Të gjitha ndërhyrjet e mirëmbajtjes do të kërkohen nga AGSCo e cila do të aktivizojë operatorin ekonomik nëpërmjet kanaleve të përcaktuara midis Palëve. Hyrja e kontraktorit në impiantet e TAP-it do të lejohet vetëm në prani të një përfaqësuesi të AGSCo që do të ofrojë asistencë teknike dhe administrative.

### **7.2 PERPILIMI I LEJES SE PUNES PTW**

Akresi në objektet e TAP-it lejohet vetëm pas përfundimit dhe autorizimit të lejes së punës (PTW Permit to Work). Përgjegjësia për përpilimin e PTW është e OPERATORIT EKONOMIK. Furnizuesi është përgjegjës për të dhënat e siguruar dhe të futura në sistemin PTW lidhur me llojin e punës që do të kryhet dhe kompetencën e personelit të punësuar.

## **8. GARANCITË DHE DETYRIMET E FURNIZUESIT**

Ndërhyrjet e jashtëzakonshme të kryera do të kenë një garanci prej 12 muajsh nga ecuria. Kontraktori do të ndërmarrë të zëvendësojë ose riparojë sipas garancisë pjesët që, si rezultat i operacioneve të sipërpërmendura, duhet të paraqesin defekte ose anomali që rezultojnë nga puna e mirëmbajtjes së kryer.

Kontraktori gjithashtu duhet të sigurojë si më poshtë:

- Të gjitha operacionet e mirëmbajtjes të mbuluara nga kontrata duhet të kryhen siç kërkohet nga ligji shqiptar dhe në përputhje me standardet HSE të AGSCo dhe TAP;
- sigurimi i të gjithë dokumentacionit kontraktual;
- aftësitë teknike të personelit dhe strukturave organizative në gjendje të operojnë edhe në panelet e kontrollit elektrik / elektronik;

Nëse në sistem zbulohen anomali të tilla si për të ndikuar në funksionimin normal të tij ose që nuk janë në përputhje me kushtet minimale të sigurisë, apo diçka tjetër që nuk mund të garantonte efikasitetin e përsosur të pajisjeve HVAC, kontraktori duhet të raportojë menjëherë faktin tek AGSCo përpara se të kryejë riparimet e nevojshme. Çdo vonesë duhet t'i komunikohet AGSCo dhe të justifikohet me shkrim, duke përfshirë edhe me e-mail.

Kontraktori duhet të paraqesë sigurimet e mëposhtme:



- Sigurimi i Pjesës së Tretë për të mbajtur Kontraktorin të paditur kundër, çdo humbjeje, dëmi, kostoje, etj lidhur me çdo dëmtim ndaj çdo personi dhe çdo dëmtim në pronë për një vlerë prej 100.000 euro.

## 9. HSE

Kontraktori duhet të respektojë të gjitha kërkesat e ligjit shqiptar, me referencë të veçantë, por pa u kufizuar në:

- Ligji për shëndetin, sigurinë dhe mjedisin;
- Kuadri rregullator i mbetjeve në Shqipëri;
- Zbatimi i rregulloreve të ADR brenda territorit shqiptar;
- Covid-19 duke trajtuar dispozitat.

Për më tepër, Kontraktori duhet të jetë në përputhje me:

- Pjesa e Anex 'AGSco HSE Minimum standards for contractors' (dhe ndryshimet e mëvonshme) që është e zbatueshme për veprimtarinë e saj dhe që ofrohet së bashku me këtë fushë shërbimesh;
- Politikat e Klientit AGSco kur aktiviteti mbahet në faqet e Klientit.

Të gjitha procedurat përkatëse që duhet të nevojiten do të jepen pas dhënies së kontratës dhe në çdo rast para hyrjes në vendet operative.

Përveç të gjitha veprimeve të kërkuara për të respektuar ligjet shqiptare, Kontraktorit i kërkohet të përgatisë përpara fillimit të aktiviteteve, një Plan specifik HSE që do të koordinohet me atë të AGSco që përmban masat në fuqi për të trajtuar rreziqet shëndetësore, të sigurisë dhe mjedisit që lidhen me kryerjen e këtyre Shërbimeve. Përveç asaj që thuhet në shtojcën 2, Plani i HSE-së ka:

Përcaktoni veprimet që duhen ndërmarrë për të kontrolluar këto rreziqe në një nivel të pranueshëm

- përmbajnë një listë të të gjithë personelit të trajnuar dhe kompetent të angazhuar në kryerjen e punës;
- përshkruani se si do të zbatohen dispozitat e AGSco dhe AGSco Client në të gjithë zinxhirin e nënkontraktimit, nëse do të ketë ndonjë nënkontrakt;
- përcaktoni organizimin dhe përgjegjësitë e QHSE-së;
- Përcaktoni se si do të menaxhohen aspektet mjedisore.

Kontraktorit mund t'i kërkohet të mbikqyrë treguesit specifikë kryesorë të performancës në baza mujore, sipas një modeli dhe periodiciteti që do të bihet dakord.

### 9.1 RREGULLAT E SJELLJES BRENDA STRUKTURAVE TË KLIENTIT AGSCO OSE AGSCO

I gjithë personeli i kontraktorit duhet të zbatojë rregullat e sjelljes që janë vendosur brenda strukturave të klientit AGSco dhe AGSco nëpërmjet planeve, procedurave, udhëzimeve të punës, standardeve, komunikimeve dhe materialit informativ.



Nëse ndonjë nga personeli i Ofruesit gjendet se derogon rregullat e përmendura më sipër, AGSco rezervon të drejtën t'i kërkojë ofruesit të zëvendësojë me efekt të menjëhershëm punonjësin.

Në veçanti, i gjithë personeli duhet të përdorë PPE-në që janë identifikuar brenda dokumentit të vlerësimit të rrezikut të Kontraktorit dhe planit të kontratës HSE sipas shtojcës 2 'AGSco HSE Minimum standards for contractors'.

## 9.2 TRAJNIM

Duke iu referuar trajnimit, dispozitat e përgjithshme të deklaruara nga shtojca 2 konsiderohen të vlefshme dhe Kontraktori është përgjegjës për të siguruar kompetencat e personelit të vet në lidhje me përmbajtjen e vlerësimit të vet të rrezikut dhe të Planit të Kontratës HSE.

Në veçanti, Kontraktori jep dëshmi, nëpërmjet certifikatave të trajnimit, regjistrave të trajnimit dhe vetëdeklarimeve se personeli që do të përdoret për të ofruar shërbimet është kompetent, edhe në lidhje me çdo autorizim specifik të kërkuar nga ligji shqiptar.

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin që të kërkojë në çdo kohë prova të kompetencave të personelit. Nëse dikush i përfshirë në dhënien e shërbimeve gjendet se nuk është kompetent për detyrën ose nuk është trajnuar në lidhje me kërkesat specifike të ligjit, AGSco mund t'i kërkojë Kontraktorit të zëvendësojë në mënyrë të detyrueshme personin me një tjetër kompetent.

## 9.3 MBETURINAT QË DALIN NGA AKTIVITETET E OPERATORIT EKONOMIK

Kontraktori është përgjegjës i vetëm për të gjitha mbeturinat që dalin nga veprimtaritë e veta (urbane, speciale, të rrezikshme dhe jo të rrezikshme) sipas dispozitave të ligjit shqiptar. Në veçanti, Kontraktori i Shërbimit siguron të saktën:

- Menaxhmenti;
- Karakterizimi dhe klasifikimi kur kërkohet;
- Transporti dhe dorëzimi në një strukturë të përshtatshme dhe të licencuar të mbeturinave (për riciklimin, ripërdorimin, trajtimin, asgjësimin).

AGSco rezervon të drejtën për vete ose për Klientin të kontrollojë se mbeturinat e prodhuara nga Kontraktori menaxhohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke kërkuar dokumentacionin e mostrës ose duke kryer auditime.

## 10. Anekset (Janë publikuar në SPE si pjesë e këtyre DT)

Aneks 1	Pajisjet dhe operimi HVAC
Aneks 2	Standardet minimale të shëndetit, sigurisë & mjedisit për kontraktuesit
Aneks 3	Struktura e kontratës

## Shtojca 8

### FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

#### 1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë veprë penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo veprë penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfituar fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

#### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.**

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

- Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

### **2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % të fondit limit të marrëveshjes kuader.

### **2.2 Kapaciteti teknik:**

2.2.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit të limit të Marrëveshjes kuader.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Mjedisit ISO 14001:2015, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit.

2.2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Çertifikatë për Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë ISO 45001, e cila duhet të jetë në fushën e objektit të prokurimit

*Të gjitha çertifikatat e mësipërme të jenë lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

2.2.5 Operatori ekonomik për realizimin me sukses të kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimumi 4 persona me kualifikimet si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier mekanik me eksperience pune në mirmbajtjen dhe instalimin e paisjeve HVAC.

- 2 (dy) Teknik elektromenakik me eksperience pune ne instalimin e paisjeve HVAC
- 1 (një) Person përgjegjës/koordinator HSE per Sigurine dhe shendetin ne pune ne perputhje me kerkesat ligjore ne fuqi i paisur me certifikaten perkatese.

Plotësimin e kërkesave të mesiperme, operatori ekonomik duhet ta provojë nëpërmjet dorezimit të këtij dokumentacioni:

- Listë pagesat e tre muajve te fundit nga data e zhvillimit te tenderit.*
- Per Inxhinierin dhe tekniket, duhet te paraqitet diploma dhe certifikata e leshuar nga institucioni perkates, kontrata e punës e vlefshme, diplomë/certifikatë.*
- Per personin pergjegjes/koordinatorin HSE, Certifikatën përkatëse të leshuar nga institucioni kompetent dhe CV perkatese.*

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 të DT. Ndërsa dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten nga OE që shpallet fitues.

2.2.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencë profesionale të shoqërisë, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihet të paktën kategoria e mëposhtme:

- NS12-A Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.

2.2.7 Operatori ekonomik për realizimin e kësaj kontrate duhet të vetëdeklarojë se nëse do të shpallet fitues do vërë në dispozicion të AK para se të nënshkruaj kontratën dhe planin zbatimit të saj, dokumentat e mëposhtme të cilat janë të domosdoshme për të realizuar kontratën me AK dhe gjithashtu për të garantuar aksesin dhe realizimin e kontrates me sukses në ambientet e TAP.

- Planin e sigurise dhe shendetit ne pune pefshire vleresimin e rrezikut specifik per aktivitetin e kesaj kontrate.
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per dhenien e ndihmes se shpejte
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per sigurine e paisjeve elektrike
- Certifikaten e trajnimit te punonjesve per sigurine e eneve ne presion
- Certifikaten e trajnimit per zonat ATEX (Atmosfere potencialisht Shperthyese)
- Certifikatë e aftë për punë, e nënshkruar nga mjeku i punës

2.2.8 Operatori ekonomik duhet të deklarojë se do zbatojë rregullat e përcaktuara në Kodin e Etikës të AGS SH.A lidhur me realizimin e objektit të kësaj kontrate. (Ky kod është i publikuar në SPE së bashku me DT).

**Bazuar në nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, dhe në formularin e kriterëve të përzgjedhjes/ kualifikimit Shtojca 8 e DT, fituesi duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dokumentat e specifikuar në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “j” si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

**Shtojca 9**

**(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)**  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

I. Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik  
\_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	----- --
Telefoni:	-----
E-mail:	----- -

